



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit*  
*Ministarstvo za Saobraćaj Postu i Telekomunikacije*  
*Ministry of Transport and Communications*

---

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 251 dhe 252 të Ligjit Nr. 02/L-70 për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor dhe nenit 4 (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 01/2007.

Me qëllim të përcaktimit të kushteve dhe procedurës për licencimin e pyetësve

Nxjerr :

**UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr.2008/2**  
**PËR LICENCIMIN E PYETËSIT**

**Neni 1**

Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohen kushtet që duhet t'i plotësoj kandidati për licencim për pyetës (ekzaminer), mënyra e dhënies së provimit, kriteret e vlerësimit, programi, pezullimi dhe revokimi i licencës së pyetësit.

**Neni 2**

**Licencimi i pyetësit**

Licenca për pyetës i lëshohet personit i cili jep provimin profesional (në tekstin e mëtutjeshëm provimi ) sipas programit të paraparë në shtojcën I dhe II të këtij Udhëzimi Administrativ.

**Neni 3**

**Kushtet për dhënien e provimit**

1. Provimit për pyetës mund t'i nënshtrohet personi i cili i plotëson kushtet si vijon:

1.1. posedon patentë shoferin e kategorisë “B” së paku tri vite.

1.2. ka mbushur 23 vjet.

1.3. nuk është i punësuar në ndonjë auto shkollë apo ka ndonjë interes financiar në Auto shkollë apo familja e ngushtë e tij.

1.4. ka përfunduar me sukses trajnimin sipas programit të këtij Udhëzimi Administrativ.

2. Pyetësi për licencim për kategoritë tjera duhet :

2.1. të posedoj patentë shoferin për kategorinë përkatëse.

2.2. të jetë pyetës i licencuar i kategorisë B së paku 3 vite.

2.3. të jep testimin teorik dhe praktik për kategorinë përkatëse.

3. Pyetësi mund të licencohet edhe me shkollë të mesme por nuk mundë të ushtroj veprimtarinë pas datës 12 Dhjetorë 2010 nëse nuk dëshmon se e ka kryer së paku shkollimin e lartë.

#### **Neni 4**

#### **Dokumentacioni për paraqitjen e provimit**

1. Për paraqitjen e provimit për pyetës kandidati duhet të paraqes këto dokumente:

1.1. Aplikacionin.

1.2. Dëshminë për përgatitjen profesionale dhe vërtetimin për përvojën e punës.

1.3. Patentë shoferin.

1.4. Letërnjoftimin apo pasaportën valide të lëshuar në Republikën e Kosovës.

1.5. Certifikatën mjekësore,

1.6. Vërtetimin e lëshuar nga Gjykata Komunale që kandidati nuk ka pengesa ligjore për ushtrimin e veprimtarisë.

2. Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Ministri në kopje kurse gjatë verifikimit prezantohet origjinali.

#### **Neni 5**

#### **Organizimi i trajnimeve**

1. Ministria do të organizoj trajnime për kandidatët për licencim për pyetës dhe trajnim për verifikimin e njohurive të pyetësit.

2. Ligjëruesit do të caktohen nga personeli i Ministrisë të cilët duhet të ketë përgatitjen shkollore superiore (fakultetin) dhe duhet të kenë përvojë së paku tri (3) vite nga fusha e komunikacionit apo juridike.

3. Fondin e orëve të ligjëratave e cakton Ministria.

### **Neni 6 Organizimi i provimit**

1. Provimi organizohet në dy pjesë :

1.1. Pjesa teorike dhe

1.2. Pjesa praktike

2 .Pjesa teorike përfshinë lëndët:

2.1. rregullat e komunikacionit dhe të sigurisë rrugore.

2.2. dispozitat që kanë të bëjnë me aftësimin e kandidatit për shofer.

2.3. teknika e komunikacionit.

2.4. njohurit mbi mjetin motorik.

2.5. psikologjinë e komunikacionit.

2.6. didaktiken .

3. Pjesa praktike përfshinë lëndët

3.1. të drejtuarit e mjetit motorik.

3.2. udhëheqja dhe vlerësimi i kandidatit për shofer.

4. Provimi nga pjesa teorike jepet me shkrim-test.

5. Provimi nga pjesa praktike jepet në mjetin motorik për kategorinë përkatëse.

### **Neni 7 Vlerësimi i provimit nga pjesa teorike**

1. Konsiderohet se kandidati ka dhënë provimin për pyetës nga pjesa teorike nëse ka arritur numrin minimal të poenave sipas lëndëve të dhënë në tabelën vijuese:

<b>Lëndët</b>	<b>Nr. i pyetjeve sipas lëndëve</b>	<b>Numri minimal i poenave</b>	<b>Kohëzgjatja e provimit (min)</b>
1. Rregullat e komunikacionit dhe të sigurisë	30	27	45
2. Dispozitat që kanë të bëjnë me aftësimin e kandidatit për shofer	20	18	30
3. Teknika e komunikacionit dhe njohurit e mjeteve motorike	20	18	30
4. Psikologjia e komunikacionit	20	18	30
5. Didaktika	20	18	30

2. Kandidati i nënshtrohet testimit sipas renditjes së dhënë në tabelë.

3. Kandidati i cili vlerësohet me notën “nuk kaloi” nuk mund të vazhdoj testimin në lëndët tjera.

4. Në ri testim kandidati nuk i nënshtrohet lëndës për të cilën është vlerësuar me notën “kaloi”.

### **Neni 8**

#### **Provimi nga pjesa praktike**

1. Provimit për pyetës nga pjesa praktike mund t’i nënshtrohet kandidati i cili më parë ka dhënë provimin nga pjesa teorike.

2. Në provim nga pjesa praktike kandidati duhet të dëshmoi se e njeh tekniken dhe metodiken e ngasjes si dhe mënyrën e udhëheqjes dhe vlerësimin e kandidatit për shofer.

3. Kandidati i cili brenda tre (3) muajve nga data e nënshtimit të testimit nga lënda rregullat e komunikacionit dhe të sigurisë nuk e jep provimin në tërësi duhet të përsërit provimin për pyetës.

### **Neni 9**

#### **Komisioni për vlerësimin e njohurive të kandidatëve për pyetës**

1. Provimi jepet para komisionit të emëruar nga Ministri.

2 Kryetari dhe anëtarët e komisionit duhet të kenë përgatitjen superiore (fakultetin) dhe përvojë pune së paku tri (3) vite.

3. Komisioni mban procesverbal gjatë procesit të vlerësimit të kandidatëve për pyetës.

### **Neni 10 Vlerësimi**

1. Kandidati vlerësohet në provim me notën “kaloi“ apo “nuk kaloi”.
2. Kandidati mund ti nënshtrohet riprovimit pas 15 ditëve.
3. Kandidati i cili nuk kalon në provim nga pjesa teorike ka të drejt që pas komunikimit të rezultetit të shikoj testin ndërsa nga pjesa praktike t’i komunikohen gabimet.
4. Afatin, vendin dhe kohën e mbajtjes së provimit për pyetës e cakton Ministria.

### **Neni 11 Përpilimi i testit**

Përpilimin e testeve nga pjesa teorike për kategorinë përkatëse dhe formularin e testit të ngasjes i përcakton Ministria.

### **Neni 12 Lëshimi i licencës**

1. Kandidati i cili e jep provimin në tërësi i lëshohet licenca për pyetës nga Ministri.
2. Licenca vlen pesë vite nga data e lëshimit.

### **Neni 13 Përtërija e licencës**

1. Përtërija e licencës bëhet në bazë të verifikimit të njohurive nga lënda rregullat e komunikacionit dhe të sigurisë rrugore .
2. Për përtërije të licencës kandidati duhet të dorëzoj dokumentacionin në bazë të nenit 4 të këtij udhëzimi Administrativ dhe licencën për pyetës (fotokopje).
3. Pyetësi i cili ka patentë shoferin për dy ose më tepër kategori me përjashtim të kategorisë “A” i nënshtrohet verifikimit të njohurive vetëm për kategorinë më të lartë.
4. Pyetësi i cili kryen me sukses testin nga lënda rregullat e komunikacionit dhe të sigurisë i përtërihet licenca.

### **Neni 14 Evidenca dhe dokumentacioni**

1. Ministria duhet të mbaj:

- 1.1. Dokumentacionin për aplikim.
- 1.2. testet.
- 1.3. formularët e ngasjes.
- 1.4. librin e evidencës së kandidatëve.

2. Libri nga nën-paragrafi 4 i paragrafit 1 të këtij neni ruhet përherë, ndërsa dokumentet tjera së paku pesë (5) vite.

### **Neni 15**

#### **Obligimet e pyetësit të licencuar gjatë testimit të kandidatit për shofer**

1. Në provim nga pjesa teorike pyetësi duhet:

- 1.1. të bëjë identifikimin e kandidatit për shofer.
- 1.2. të jep udhëzime për plotësimin e testit dhe kriteret e vlerësimit.
- 1.3. gjatë kohës së testimit të mbikëqyrë sjelljet e kandidatëve.
- 1.4. pas kontrollimit të testit të komunikoi rezultatin.

2. Në provim nga pjesa praktike pyetësi duhet:

- 1.1. të verifikoj dokumentacionin e mjetit motorik.
- 1.2. me shikim vizual të konstaton se mjete motorik me të cilin mbahet provimi i plotëson kushtet e parapara për mbajtjen e provimit.
- 1.3. të bëjë identifikimin e kandidatit për shofer.
- 1.4. të plotësoj formularin e testit të ngasjes.
- 1.5. të bëjë vlerësimin e kandidatit për shofer sipas kriterëve të parapara në shtojcën II të këtij Udhëzimi Administrativ.
- 1.6. të rekomandoj orë plotësuese kandidatit i cili vlerësohet me notën “nuk kaloi”.

1.7. të rekomandoj kandidatin i cili gjatë verifikimit të testit të pamurit rezulton si negativ që të sjell dëshmi plotësuese nga oftamologu për aftësitë e të pamurit brenda shtatë (7) ditëve dhe i njëjti përsërit provimin me të njëjtën pagesë.

3. Për mbajtjen e provimeve nga pjesa teorike dhe praktike pyetësi duhet të përgatit raportin ditor, javor, mujor, gjashtëmujor dhe vjetor .

4. Kandidati i pakënaqur me vlerësimin e pyetësit mund të ushtrojë ankesë brenda njëzetekatër (24) orëve në Njësinë Regjionale përkatëse të cilën e ankesë e shqyrton komisioni.

### **Neni 16**

#### **Zbatimi i legjislacionit**

Gjatë testimit të kandidatit për dhënien e provimit për shofer nga pjesa teorike dhe praktike pyetësi duhet të zbatoj dispozitat e Ligjit për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor dhe aktet tjera nënligjore.

### **Neni 17**

#### **Pezullimi i licencës të pyetësit**

1. Licenca i pezullohet pyetësit në kohë zgjatje prej tre (3) deri gjashtë (6) muaj nëse vepron në kundërshtim me Ligjin për Siguri në Komunikacionin rrugor dhe aktet e tjera nënligjore dhe rregullat e shërbimit civil dhe kodin e mirësjelljes .

2. Pyetësit i pezullohet licenca nëse e ka të ndaluar nga organi kompetent të drejtuarit e mjetit me veprim motorik.

### **Neni 18**

#### **Revokimi i licencës të pyetësit**

Pyetësit i revokohet licenca nëse:

1.1. Keqpërdor vendin e punës për përfitime materiale.

1.2. Jep të dhëna të cilat janë konfidenciale.

1.3. Sjellë dëshmi të rrejshme në dokumentacion për licencim ose verifikim të njohurive.

1.4. Nëse për shkak të gjendjes shëndetësore nuk është i aftë të zhvilloj këtë veprimtari.

1.5. shkelë rregullat e shërbimit civil dhe kodin e mirësjelljes

**Neni 19**  
**Procedura e ankimit**

1. Pyetësi ka të drejtë të ushtroj ankesë në Ministri në pajtim me Ligjin e Procedurës së Përgjithshme Administrative.
2. Komisioni i emëruar nga Ministri vendos lidhur me ankesën.

**Neni 20**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Transportit dhe Postë Telekomunikacionit.

Fatmir Limaj,

\_\_\_\_\_  
Ministër i Transportit dhe Postë Telekomunikacionit

Datë\_\_\_\_\_.



## SHTOJCA I.

### **A) PËRMBAJTA E PROGRAMIT TË PROVIMIT PËR PYETËS**

#### **1. Rregullat e komunikacionit dhe të sigurisë**

- rregullat e komunikacionit dhe të sigurisë janë të parapara në shtojcën e Udhëzimit Administrativ nr 2008/9 për dhënien e provimit për shofer.

#### **2. Dispozitat që kanë të bëjnë me aftësimin e kandidatëve për shoferë:**

- Ligji nr.02/L-70 për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor, Ligji nr.2004/1 për Transportin Rrugor, Ligji nr. 02/L-127 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Transportin rrugor nr.2004/1, Ligji nr.2004/6 Për Transportin e Mallrave të Rrezikshme, Ligji nr 2003/11 Për Rrugët dhe aktet tjera nën ligjore të nxjerra në bazë të këtyre ligjeve .

#### **3. Teknika e komunikacionit**

Përmbajta :

##### ***a) faktorët e sigurisë në komunikacion***

- faktorët bazë dhe ndihmës të sigurisë;
- mjeti si faktor i sigurisë;
- rruga si faktor i sigurisë;
- faktorët ndihmës ( faktorët klimatik, mjetet për drejtimin e komunikacionit, rregullat e komunikacionit, kontrollimi i komunikacionit).

##### ***b) lëvizja mekanike e mjetit***

- qendra dhe stabiliteti i mjetit;
- rezistenca e ngasjes;
- shpejtësia;
- rruga e ndaljes së mjetit;
- distanca ndërmjet mjeteve në kolonë;
- përballkalimi;
- anashkalimi dhe
- tejkalimi.

##### ***c) kapaciteti i rrugës***

- mënyra e udhëheqjes së komunikacionit në zonën e kryqëzimit;

- rregullimi i komunikacionit ( semaforët, vala e gjelbër);
- karakteristikat bazë të komunikacionit për këmbësor;
- parkimi;
- mirëmbajtja e mjetit nga aspekti i sigurisë në komunikacion.

#### **4. Njohurit mbi mjetin motorik:**

Mjeti në funksion të sigurisë në komunikacionin rrugor;

- pajisjet me rëndësi të veçantë për sigurinë e komunikacionit rrugor ;
- pajisjet bashkëkohore në automjet, ABS–sistemi kundër bllokimit të rrotës, ESP–programi i stabilizimit elektronik, ASR – rregullimi i rrëshqitjes motorike, GPS–sistemi i pozicionimit global, EBS–sistemi i rregulluar elektronik për frenim, GRA–pajisja për rregullimin e shpejtësisë;
- sistemi për regjistrimin automatik të dhënave siç është precizuar me dispozitën EEC–tahografi;
- pajisja për dukshmëri normale, ndriçimi, sinjalizimi, kyçja etj
- pajisjet dhe pajimet tjera (rrotat, gomat, tabela instrumentale, transmisionit, pajisjet mbështetse etj).

#### **5. Psikologjia e komunikacionit:**

- Metodrat dhe veprimet në psikologjinë e të mësuarit, perceptimi i situatës së komunikacionit;
- Format , metodat dhe mësimi, faktorët e mësimit të suksesshëm, vëditimi të mbajturit mend dhe harresa;
- Procesi i arritjes së shkathtësive;
- Personaliteti i kandidatëve për shoferë dhe aftësitë për t'u gjendur në situata të ndërlikuara në komunikacion;
- Ndikimi i motivimit në arritjen e dijes;
- Ndikimi i emocioneve në sjelljen në komunikacion;
- Raporti ndaj kandidatit për shofer.
- Etika

#### **6. Didaktika:**

- Nocionet themelore të didaktikës;
- Çështjet metodologjike të didaktikës;
- Organizimi dhe metodat mësimore, format e veçanta të organizimit të mësimit në auto shkolla, mësimi teorik dhe praktik për kandidatë për shoferë, rrethi mësimor, përgatitja për të mbajtur orën mësimore;

- Njohja, vlerësimi i dijes së kandidatit , karakteristikat individuale të kandidatit, veprimet subjektive dhe objektive në vlerësimin e dijes së kandidatit;

## **7. Të drejtuarit e mjetit motorik**

- Në të drejtuarit e mjetit motorik kandidati për pyetës duhet të tregoi aftësi të larta të teknikës dhe metodikës së ngasjes, të bëjë udhëheqjen dhe vlerësimin kandidatit .

### *a) Ngasja në rrugë publike të kategorizuara*

- përcjellë rrjedhjen e komunikacionit,
- vepron sipas rregullave të komunikacionit
- parashikon mundësitë e dukurive dhe sjellja e pjesëmarrësve tjerë në situata konkrete të komunikacionit
- kryen me rregull veprimet me mjet në bazë të marrjes së vendimeve të drejta.
- ngasja defansive (mbrojtësi)
- ngasja ekonomike dhe ekologjike

### *b) Udhëheqja dhe vlerësimi i kandidatit për shofer*

Në këtë pjesë të provimit kandidati për pyetës duhet të:

- ketë aftësi komunikuese dhe të përdor gjuhë të unisuar,
- udhëheq kandidatin gjatë ngasjes në rrugë publike,
- vlerëson sjelljen dhe teknikën e ngasjes,
- vlerëson mënyrën e sjelljes dhe reagimin e kandidatit në situata konkrete të komunikacionit,
- bënë vlerësimin përfundimtar të kandidatëve sipas formularit të vlerësimeve të gabimeve e cila është paraparë në shtojcën II të këtij Udhëzimi Administrativ
- Pasi të përfundoj ngasja, kandidati për pyetës duhet t'ia komunikoj gabimet e bëra të cilat i ka të shënuar në formularin e ngasjes. .

## **B) KRITERET E VLERËSIMIT**

### **1. Pjesa teorike**

- Pyetjet në test duhet të kenë së paku dy përgjigjeje, ku një ose më shumë duhet të jenë të sakta.
- Pyetja vlerësohet me një poenë.
- Gjatë plotësimit të testit kandidati duhet ti përmbahet rregullave të Udhëzimit Administrativ për dhënien e provimit për shofer.

## 2). Pjesa praktike

- Pjesa e parë e provimit nga pjesa praktike epet në poligon sipas Udhëzimit Administrativ 2008/9 për dhënien e provimit për shofer por kandidati duhet ti kryej të gjitha veprimet të parapara dhe nuk lejohet përsëritja tyre.
- Kandidati i cili kryen me sukses veprimet në poligon, vazhdon ngasjen në rrugë publike.
- Komisioni e vlerëson pyetësin në bazë të teknikës së ngasjes, udhëheqjes së kandidatit, komunikimit të gabimeve dhe vlerësimit përfundimtar qe jep kandidati për pyetës.
- Gabimet vlerësohen si gabim i vogël, serioz dhe i rrezikshëm. Kandidati i cili vlerësohet me një gabim serioz ose të rrezikshëm nuk kalon në provim. Kandidati i cili gjatë ngasjes i bënë pesë (5) gabime të vogla ose i përsërit dy (2) herë të njëjtin gabim të vogël nuk kalon në provim.
- Kohëzgjatja e provimit nga lënda të drejtuarit e mjetit me veprim motorik në rrugë publike është së paku 45 minuta.

### **C) TRAJNIMET PËR PYETËS TË NGASJES**

Ministria për pyetës do të mundësojë së paku:

*a) një trajnim te rregullt periodik prej katër ditësh brenda periudhës 2 vjeçare ne mënyrë qe:*

- t'i rifreskojnë njohurit dhe aftësitë testuese,
- te zhvillojë kompetenca te reja qe janë esenciale për ushtrimin e detyrave te tyre.
- te sigurojnë qe një pyetës vazhdon te mbikëqyr testimet me standard te larta dhe korrekte.

*b) se paku një trajnim periodik prej se paku 5 ditë brenda periudhës 5 vjeçare,*

- te zhvillohet dhe ruhet aftësia e të ngasurit praktik.

Në rast se pyetësi në periudhën brenda 2 vite nuk e ka kryer veprimtarin si pyetës për kategorinë përkatëse duhet që para fillimit të ushtrimit të kësaj veprimtarie ti nënshtrohet verifikimit të njohurive .

## SHTOJCA II.

VLERËSIMI I GABIMEVE GJATË TESTIMIT PRAKTIKË NË RRUGË PUBLIKE	GABIM I VOGËL	SERIOZ	RREZIKSHËM
<b>1. PËRGATITJA PËR NGASJE</b>			
Mos kryerja e kontrollimit teknik ditor preventiv( kontrollimi i vajit, lëngut për ftohje dhe larjen e xhamit,pneumatiket, tahografin, sistemin sinjalizues dhe ndriçues, pajisjeve për kyçje dhe ç'kyçje të bashkësisë së mjeteve dhe pajisjet tjera)	X		
Mos përshtatja e ulëses dhe pasqyrave	X		
Mos përdorimi i rripit te sigurisë	X		
Mos përshtatja e mbështetëseve të kokës (nëse janë në dispozicion)	X		
Mos përdorim i dritave adekuate për ngasje ditën	X		
<b>2. KYÇJA NË RRUGË PUBLIKE</b>			
Orientohet në pasqyre, nuk shikon këndin e vdekur (pa pjesëmarrës tjerë në komunikacion)	X		
Orientohet në pasqyre nuk shikon këndin e vdekur ( me pjesëmarrës tjerë në komunikacion)		X	
Pengon pjesëmarrësit tjerë në komunikacion		X	
<b>3. PAISJET SINJALIZUESE DHE PARALAJMRUESE</b>			
Mos dhënia e tregueseve të drejtimit	X		
Mos dhënia e sinjaleve paralajmëruese të zërit dhe dritës	X		
<b>4. MBAJTJA E DREJTIMIT NË RRUGË</b>			
Pozita jo e rregullt mjetit në shiritin rrugor	X		
Mos mbajta e drejtimit në rrugë		X	
<b>5. SHPEJTËSIA E LËVIZJES</b>			
Tejkalimi i shpejtësisë së lëvizjes nga 10 % deri 20 % mbi shpejtësinë e lejuar	X		
Tejkalimi i shpejtësisë së lëvizjes mbi 20 % të lejuar		X	
Mospërshtatja e shpejtësisë kushteve dhe rrethanave në rrugë	X		
Ngasja e ngadalshme duke penguar rrjedhën normale të komunikacionit		X	
<b>6. FRENIMI DHE NXITIMI I VRULLSHËM</b>			
Frenimi i vrullshëm pa nevojë		X	
Nxitimi i vrullshëm		X	
Frenimi i lirë jo i rregullt	X		
<b>7. KTHIMI NË RRUGË</b>			
Pengon pjesëmarrësit tjerë në rrugë .		X	
Rreshtimi jo i rregullt		X	
Kalimi mbi trotuar (pa pjesëmarrës )	X		
Kalimi mbi trotuar (me pjesëmarrës )		X	
Ndërrimi i kahjes së lëvizjes me ose pa manovrim .	X		

<b>8. SJELLJA NDAJ KËMBËSOREVE</b>			
Mos respektimi i përparësisë së kalimit të këmbësorëve në vendkalim			X
Mos kujdesi ndaj fëmijëve që gjenden në rrugë.			X
Rrezikimi i këmbësorëve gjatë kthimit me mjet në rrugën anësore ku nuk ekziston vendkalimi i shënuar për këmbësorë.			X
Mos kujdesi ndaj këmbësorëve të cilat gjenden në afërsi të vendkalimit të shënuar për këmbësor.	X		
Mos kujdesi gjatë kalimit të rrugës personave me aftësi të kufizuar, verbërve, moshuar dhe fëmijëve			X
<b>9. TEJKALIMI DHE ANASHKALIMI</b>			
Tejkalimi ose anashkalimi jo i rregullt		X	
<b>10. PËRBALLKALIMI</b>			
Mos respektimi i përparësisë së kalimit gjatë përballë kalimit		X	
Mos mbajta e distancës së sigurisë anësore.		X	
<b>11. SJELLJA GJATË NGASJES</b>			
Mos mbajtja e distancës gjatësor( më pak se një sec).		X	
Mos mbajtja e distancës në kushte të vështira atmosferike (më pak se 3 sec)		X	
Mos veprimi adekuat ndaj mjetit të transportit publik të udhëtarëve	X		
Nuk mundet të nisët në mënyrë të rregullt në pjerrtësi gjatësore (përpjetë ose teposhtë) pas tentimit të dytë.		X	
Mos respektimi i përparësisë së kalimit të mjeteve nën përcjellje dhe me përparësi kalimi(me sinjale të veçanta ndriçuese dhe akustike të kyçura)		X	
Mos respektimi i rregullave ,shenjave dhe semaforëve gjatë ngasjes në vendkalimin hekurudhor		X	
Fikja e motorit	X		
Mbajta e timonit në mënyrë jo të rregullt	X		
Përdorimi i frikcionit pa nevojë	X		
Mos përshtatja e shpejtësisë shkallës së transmisionit –ndërruesit të shpejtësisë	X		
Mos vështrimi komunikacionin nga prapa ( nuk orientohet në pasqyre) gjatë ngasjes	X		
<b>12. KRYQËZIMI</b>			
Mos përshtatja e shpejtësisë kushteve dhe rrethanave të kryqëzimit	X		
Nuk e vëzhgon situatën gjatë kthimit		X	
Kalimi në dritën e verdhë në semafor ku mundet të ndalet në mënyrë të sigurt		X	
Hyrja në kryqëzim në të cilën ka ngecur (bllokuar) komunikacioni	X		
Gjatë kthimit majtas nuk u jep përparësi mjeteve të cilat lëvizin drejt nga kahja e kundërt ose kthehen djathtas.		X	
Gjatë kthimit nuk rreshtohet në mënyrë të rregullt	X		
Gjatë kthimit i rrezikon këmbësorët të cilët kalojnë rrugën në vendin ku nuk ekziston vendkalimi i tyre.			X
Hyrja dhe dalja jo e rregullt në kryqëzimin me rreth rrotullim.	X		
<b>13. PËRDORIMI I DRITAVE GJATË NGASJES NATËN</b>			
Nuk i ndezë dritat për ndriçimin e rrugës		X	
Mos përshtatja e shpejtësisë varësisht nga dritat që përdoren natën	X		
Mos përdorimi adekuat i dritave gjatë lëvizjes pas mjetit dhe me rastin e përballkalimit		X	
<b>14. NDRRIMI I SHIRITIT</b>			
Mos vështrimi (prapa, anash dhe këndin e vdekur) pa pjesëmarrës në rrugë	X		

Mos vështrimi(prapa, anash dhe këndin e vdekur) me pjesëmarrës në rrugë.		<b>X</b>	
Pengon pjesëmarrësit në komunikacion gjatë ndërrimit të shiritit		<b>X</b>	
<b>15. SHENJAT E KOMUNIKACIONIT</b>			
Mos respektimi i shenjave të cilat rregullojnë përparësinë e kalimit, ndalimit, obligimit.		<b>X</b>	
Mos respektimi i shenjave ndriçuese te komunikacionit(semaforëve)		<b>X</b>	
Mos respektimi i shenjave të shënuar në rrugë dhe shenjave tjera.		<b>X</b>	
<b>16. SHENJAT DHE URDHËRAT E PERSONIT TË AUTORIZUAR</b>			
Mos respektimi i shenjave dhe urdhrave të personit të autorizuar.		<b>X</b>	
<b>17.TË TJERAT</b>			
Veprimet të cilat ndëshkohen me pikë negative në bazë të Ligjit të Sigurisë në Komunikacion Rrugor.		<b>X</b>	
Shofer instruktori ose pyetësi vepron nëse kandidati gabon		<b>X</b>	

Fatmir Limaj,

\_\_\_\_\_  
Ministër i Transportit dhe Postë Telekomunikacionit

Datë\_\_\_\_\_.